



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 18225/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Ramiz Kryeziu nga fsh. Belivore K. Kamenicë për kundërvajtje nga neni 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 31.10.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Ramiz Hysen Kryeziu, i lindur më 30.04.1957 ne Muqiverc, tani me vendbanim në fsh. Belivore K. Kamenic, këshilltar në ministrinë për mirëqenie dhe punë sociale, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtar të lartë publik, këshilltar në ministrinë për mirëqenie dhe punë sociale, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili bëhet me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) EURO. Gjorbën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No.1000-4300-7000-0518

Pagesa bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata. Nëse brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditë duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) EURO në një ditë burg.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur kurse në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) EURO në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr. 01 -1828/2012 të dt 18.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marrë Konkluzion.

Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij pohoj se unë në muajin prill të viti 2011 e kam marrë këtë detyrë, dhe sa e di unë e kam mbushur një formular të tillë, por sa i përket vitit të tanishëm, unë nuk e kam pranuar asnjë formular të tillë për ta mbushur këtë formular, ku e pranoj kundërvajtjen po shihen se pengesat kanë qenë tek organet e Ministrisë të cilët nuk me kanë informuar për këtë aplikacion për mbushjen e tij.

Në deklaratën e dhanë të dëshmitarit Adem Bajgora sa i përket rastit të Ramizit i cili e ka funksionin në Ministrinë, këshilltar ministri unë e kam punë listën për të dërguar imelën në agjencionin me dt. 15.02.2012 ku emri i këshilltarit ka qenë në këtë listë dhe i obliguar për deklarimin e pasurisë dhe me dt. 1 mars e kemi pranuar imelën dhe po atë ditë jav ka kam dërgu përmes imelles zyrtare të kësaj ministrie, dhe për sa i përket rastit të Ramiz Kryeziut ky nuk ka pas imell të hapur, dhe fizikisht unë formularin nuk e kam dërgu që ta plotëson dhe të jetë në dijeni, dhe këto janë arsye që Ramizi nuk ka qenë në dijeni për këtë formular.

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjua deklarata e parashtruesit të kërkesës Enis Sadiku i cili deklaroj se na si agjencion i kemi pikat kontaktuese në çdo subjekt ku na i dërgon edhe listat me emrat e personave që janë të autorizuar që të paraqesin pasurinë mbi deklarimin e pasurisë ku afat për deklarimin e rregullt është deri me dt. 31 mars nga ministria për punë dhe mirëqenie sociale e kemi pranuar listat e zyrtarëve të lartë publik ku ndër këta ka edhe Ramiz Kryeziu ku në agjencionin tonë nuk kemi pranuar deklarata deri me 31 mars me 31 mars 2012 për vitin 2011 ku dhe kemi bërë kërkesë ku kërkesa,

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtualla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

V E N D O S I G J Y K A T A K O M U N A L E P Ë R K U N D Ë R V A J T J E N Ë P R I S H T I N Ë

G J Y K A T A P Ë R K U N D Ë R V A J T J E

D E N D I M E: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksë.

